

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **626-26-5623-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim per subvencionim i bujqeve ,mjeshtreve dhe graveve per fuqizim permes paisjeve te punes**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K.
NUI	810396772
Adresa	Xhelal Hajda - Toni
Vendi	Rahovec
Kodi postar	162
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Shkumbin Haxhijaha
Adresa elektronike	info@haxhijaha.com
Data e parashtrimit të ankesës	21.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim për subvencionim i bujqeve ,mjeshtrëve dhe graveve për fuqizim përmes paisjeve të punës

1. Njoftim për Kontratë – 14.07.2026
2. Formulimi standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara – 15.07.2026
3. Proces verbal i hapjes së Tenderëve – 24.08.2026
4. Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues - 09.09.2026
5. Kërkesë për qasje në dokumentacion – 10.09.2026
6. Mundësia për qasje në dokumentacion – 14.09.2026
7. Kërkesa për rishqyrtim: 14.09.2026
8. Pergjigje për kërkesën në rishqyrtim: 16.09.2026
9. Ankesa në OSHP: 21.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Nuk pajtohem me vendimin e AK-se

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ankesa mund të dorëzohet, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Ne konsiderojmë që AK ka shkelur dispozitat ligjore në keto Nene:

Neni 1: Qëllimi

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60: Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datë 09.09.2026, në ora 16:26, kemi pranuar përmes platformës së E-Prokurimit njoftimin lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ne, si Operator Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, menjëherë më datë 10.09.2026, në ora 11:07, kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës të aktivitetit të prokurimit, përmes adresës elektronike zyrtare të përcaktuar në dosjen e tenderit, përkatësisht në adresën: afoniqi07@gmail.com.

Më datë 11.09.2026, në ora 10:32, kemi pranuar përgjigje nga kjo adresë elektronike,

përmes së cilës jemi njoftuar se kërkesa për qasje në dokumentacion duhej të dërgohej në një adresë tjetër elektronike, e cila nuk ishte e specifikuar në dosjen e tenderit.

Megjithatë, me qëllim të realizimit të së drejtës sonë për qasje në dokumentacionin përkatës, në të njëjtën ditë, më 11.09.2026, kemi dërguar kërkesën për qasje edhe në adresën elektronike të na është përcaktuar përmes përgjigjes së pranuar.

Pavarësisht se kërkesa jonë për qasje ishte parashtruar menjëherë pas pranimi të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ishte përcjellë në adresën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, qasja në dokumentacion na është mundësuar vetëm më datë 14.09.2026.

Rrjedhimisht, theksojmë se nga momenti i pranimi të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, kemi vepruar pa vonesë dhe kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar qasje në dokumentacionin përkatës. Vonesa në mundësimin e qasjes nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë neglizhence apo mosveprimi nga ana jonë, por si rezultat i faktit se kërkesa jonë fillestare ishte dërguar në adresën elektronike zyrtare të specifikuar në dosjen e tenderit, ndërsa më pas jemi udhëzuar që kërkesën ta dërgojmë në një adresë tjetër, e cila nuk ishte e përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

-Pretendimi ynë nuk ka qenë i natyrës ankuese, por më tepër informuese, duke marrë parasysh kufizimin e kohës në dispozicion për të analizuar çështjen dhe për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Për më tepër, përmes këtij pretendimi kemi theksuar se, përveç faktit që qasja në dokumentacion na është mundësuar vetëm në ditën e fundit të afatit për paraqitjen e ankesës, edhe koha e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues për sigurimin e dokumentacionit ka qenë e kufizuar. Si rrjedhojë, këto rrethana kanë ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë tonë për të analizuar në mënyrë të plotë dokumentacionin dhe për të paraqitur pretendimet tona në kohën e paraparë.

1. Autorizimi i lëshuar për SHKELCEN SYLAJ B.I.

Pas mundësimit të qasjes në dokumentacionin e tenderuesve, gjatë shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, kemi evidentuar një mospërputhje në autorizimin e lëshuar për Operatorin Ekonomik **SHKELCEN SYLAJ B.I.** nga kompania **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.**

Konkretisht, në autorizimin e lëshuar nga **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.** është evidentuar numri i identifikimit (NUI) **811021235**, ndërsa sipas të dhënave të Operatorit Ekonomik **SHKELCEN SYLAJ B.I.**, numri i tij unik i identifikimit (NUI) është **811021253**.

Pra, ekziston një mospërputhje e qartë në numrin unik të identifikimit të Operatorit Ekonomik të shënuar në autorizim, pasi numri **811021235** i evidentuar në autorizim nuk

përputhet me numrin zyrtar **811021253** të Operatorit Ekonomik SHKELCEN SYLAJ B.I.

Kjo mospërputhje është materialisht e rëndësishme për vlerësimin e vlefshmërisë dhe besueshmërisë së autorizimit të paraqitur në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi dokumenti duhet të identifikojë në mënyrë të saktë dhe të padyshimtë Operatorin Ekonomik të cilit i është lëshuar autorizimi.

-Në lidhje me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar atë si të pabazuar, mirëpo vlerësojmë se ky qëndrim nuk e ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe konkrete thelbin e pretendimit tonë.

Pretendimi ynë nuk është bazuar thjesht në të dhënat e publikuara në portalin e ARBK-së, por në mospërputhjen konkrete të të dhënave të paraqitura në dokumentacionin e dorëzuar për operatorin ekonomik të propozuar për kontratë, përkatësisht për operatorin ekonomik “Shkelcen Sylaj B.I.”.

Konkretisht, në autorizimin e lëshuar për këtë operator ekonomik figuron numri unifikues **811021235**, ndërsa numri unifikues i operatorit ekonomik “Shkelcen Sylaj B.I.”, sipas të dhënave përkatëse, është **811021253**. Pra, ekziston një mospërputhje e qartë ndërmjet numrit unifikues të shënuar në autorizim dhe numrit unifikues të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, çështja e ngritur nga ana jonë ka të bëjë me përputhshmërinë dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, dhe jo vetëm me verifikimin e të dhënave të tij në portalin e ARBK-së. Fakti që Autoriteti Kontraktues i është referuar të dhënave të ARBK-së nuk e adreson në vetvete mospërputhjen që ne kemi identifikuar në dokumentin e dorëzuar në kuadër të procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues është dashur të analizojë në mënyrë konkrete mospërputhjen ndërmjet numrit **811021235**, të shënuar në autorizim, dhe numrit **811021253**, që i atribuohet operatorit ekonomik “Shkelcen Sylaj B.I.”, si dhe të sqarojë nëse dokumenti i paraqitur i referohet realisht operatorit ekonomik të propozuar për kontratë.

2. Autorizimi i paraqitur nga SHKELCEN SYLAJ B.I. nuk përmbush kërkesën e FTD-së për autorizim nga prodhuesi

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), në pikën 5, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si kërkesë që Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit të dorëzojnë **autorizim nga prodhuesi për pajisjet e ofruara**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik **SHKELCEN SYLAJ B.I.**, kemi konstatuar se si dëshmi për përmbushjen e kësaj kërkesë është paraqitur një autorizim i lëshuar nga kompania **QINGDAO RED LETTER IMPORT**

AND EXPORT Co.

Megjithatë, nga vetë emërtimi dhe natyra e subjektit që ka lëshuar autorizimin, rezulton se bëhet fjalë për një kompani që merret me **import dhe eksport, si dhe me veprimtari tregtare/shitblerje**, dhe jo për prodhuesin e pajisjeve për të cilat është kërkuar autorizimi.

Kjo është me rëndësi të veçantë, pasi kërkesa e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në pikën 5 të FTD-së nuk kërkon thjesht një autorizim nga një subjekt tregtar, distributor apo ndërmjetës, por specifikisht kërkon **autorizim të lëshuar nga prodhuesi**.

Rrjedhimisht, nëse QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. nuk është prodhuesi i pajisjeve të ofruara, por vetëm subjekt tregtar që merret me import, eksport dhe shitblerje të tyre, atëherë autorizimi i lëshuar nga ky subjekt nuk përputhet me kërkesën e përcaktuar shprehimisht në FTD.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të ofertës, është i obliguar të verifikojë nëse dokumentacioni i dorëzuar nga Operatori Ekonomik përmbush saktësisht kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Në rastin konkret, duhet të verifikohet nëse subjekti QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. ka statusin dhe kapacitetin e **prodhuesit** të pajisjeve për të cilat është lëshuar autorizimi, apo nëse bëhet fjalë vetëm për një distributor/tregtar.

Për më tepër, kjo çështje duhet të shqyrtohet në ndërlidhje edhe me mospërputhjen e numrit unik të identifikimit të Operatorit Ekonomik të evidentuar në autorizim, të cilën e kemi paraqitur në pretendimin tonë të parë.

-Në lidhje me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar atë si të pabazuar, duke iu referuar dokumentit të paraqitur nga operatori ekonomik. Megjithatë, vlerësojmë se arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues nuk i adreson në mënyrë konkrete dy faktet kryesore të ngritura nga ana jonë në kërkesën për rishqyrtim, të cilat bazohen pikërisht në dokumentacionin e paraqitur në kuadër të kësaj procedure.

Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi evidentuar këto dy fakte:

Fakti i parë – emërtimi dhe veprimtaria e kompanisë nga Kina

Në dokumentacionin e paraqitur, kompania nga Kina figuron me emërtimin që përmban shprehjen **“EXPORT IMPORT”**, ndërsa kompanitë që janë prodhuese zakonisht identifikohen në emërtimin e tyre me termin **“MANUFACTURE”** ose me një përcaktim tjetër që lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë prodhuese.

Kjo rrethanë ka ngritur nga ana jonë një çështje konkrete lidhur me statusin dhe veprimtarinë reale të kësaj kompanie, përkatësisht nëse ajo është prodhuese e produkteve për të cilat është dhënë autorizimi apo nëse vepron si subjekt i angazhuar në veprimtari të eksportit dhe importit/furnizimit.

Fakti i dytë – përmbajtja e autorizimit të lëshuar për AGRIBAU SH.P.K.

Përveç kësaj, kemi paraqitur si fakt edhe autorizimin e lëshuar nga e njëjta kompani për **AGRIBAU SH.P.K.**, në të cilin kompania kineze e përshkruan veten në mënyrë të qartë

si:

“who is established and reputable supplier”

që në shqip nënkupton **“furnizues i konsoliduar dhe me reputacion”**.

Ky formulim është veçanërisht relevant për pretendimin tonë, pasi vetë kompania, në një dokument të saj zyrtar, e përshkruan veten si **“supplier” (furnizues)** dhe jo si **“manufacturer” (prodhues)**.

Prandaj, këto dy fakte të paraqitura nga ana jonë kanë kërkuar një verifikim konkret të statusit të kompanisë kineze dhe të cilësisë së saj si prodhuese apo furnizuese. Referimi i Autoritetit Kontraktues vetëm në dokumentin e bashkangjitur nga operatori ekonomik, pa u dhënë përgjigje këtyre dy rrethanave konkrete të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, nuk e adreson në tërësi thelbin e pretendimit tonë.

3. Paraqitja e vetëm një autorizimi nga prodhuesi për pajisjet e ofruara

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si kërkesë që Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin **autorizim nga prodhuesi për pajisjet të cilat i ofrojnë** në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë, kemi konstatuar se në dokumentacionin e ofertës është paraqitur **vetëm një autorizim**.

Megjithatë, nga përmbajtja e dokumentacionit të dorëzuar nuk është e qartë se ky autorizim mbulon të gjitha pajisjet e kërkuara dhe të ofruara në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, apo vetëm një pjesë të tyre.

Në rastin konkret, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për qasje, nuk mund të konstatohet qartë se për pajisjet e tjera të ofruara ekziston autorizimi përkatës nga prodhuesit. Paraqitja e vetëm një autorizimi, pa specifikuar qartë shtrirjen e tij dhe pa dëshmuar se cilat pajisje mbulohen me këtë autorizim, krijon paqartësi në lidhje me përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në FTD.

-Në lidhje me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar atë si të pabazuar, me arsyetimin se në kërkesat e tenderit është kërkuar “Autorizim”, në njëjës, dhe jo autorizime të veçanta për secilin artikull.

Vlerësojmë se ky arsyetim nuk e trajton thelbin e pretendimit tonë. Çështja e ngritur nga ana jonë nuk lidhet me interpretimin formal të përdorimit të fjalës “Autorizim” në njëjës, por me faktin nëse autorizimi i paraqitur nga operatori ekonomik mbulon në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme **produktet/artikujt për të cilët është dhënë oferta**, përfshirë edhe detyrimet që rrjedhin nga periudha e garancisë.

Produktet e përfshira në këtë tender nuk janë të gjitha të së njëjtës natyrë dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht produkte të një prodhuesi të vetëm. Përkundrazi, kemi të bëjmë me produkte të ndryshme, të cilat mund të jenë të prodhuesve të ndryshëm dhe për të cilat kërkohet sigurimi i garancisë dhe mbështetjes teknike gjatë periudhës garantuese.

Pikërisht për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet automatikisht se një autorizim i vetëm, pa përcaktuar qartë produktet, prodhuesin/prodhuesit dhe shtrirjen e autorizimit, mbulon të gjithë artikujt e tenderit.

Një element veçanërisht i rëndësishëm është fakti se për produktet e kërkuara parashihet **periudhë garantuese**. Përmbushja e këtij detyrimi nuk mund të mbetet vetëm në nivel deklarativ nga operatori ekonomik, por duhet të ekzistojë një bazë e verifikueshme që gjatë periudhës së garancisë produktet do të mund të servisohen dhe, kur është e nevojshme, të pajisen me pjesë origjinale nga prodhuesi përkatës.

Në mungesë të një autorizimi të qartë nga prodhuesi përkatës, i cili konfirmon se operatori ekonomik është i autorizuar të furnizojë, mbështesë dhe/ose servisojë produktet përkatëse gjatë periudhës së garancisë, ekziston rreziku real që operatori ekonomik të mos jetë në gjendje të sigurojë servisimin e produkteve dhe pjesët origjinale të nevojshme nga prodhuesi.

Prandaj, pretendimi ynë nuk është se Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar vetëm për shkak të përdorimit të fjalës “Autorizim” në njëjës të kërkojë domosdoshmërisht një dokument të veçantë për çdo artikull. Pretendimi ynë është se **autorizimi i paraqitur duhet të dëshmojë qartë mbulimin e produkteve të ofruara dhe mundësinë e përmbushjes së detyrimeve të garancisë për ato produkte**.

Nëse produktet e ofruara janë të prodhuesve të ndryshëm, atëherë duhet të verifikohet në mënyrë konkrete se cili prodhues e ka autorizuar operatorin ekonomik dhe cilat produkte mbulohen nga ky autorizim. Përndryshe, një autorizim i përgjithshëm, pa përcaktim të qartë të shtrirjes së tij, nuk mund të merret automatikisht si dëshmi se të gjithë artikujt e tenderit janë të mbuluar nga prodhuesit përkatës dhe se operatori ekonomik do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e garancisë.

Për këto arsye, konsiderojmë se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues, i cili e ka kufizuar çështjen vetëm në faktin se është kërkuar “Autorizim” në njëjës, nuk i përgjigjet thelbit të pretendimit tonë, pasi nuk sqaron se **cilat produkte mbulohen nga autorizimi i paraqitur, nga cili prodhues janë ato produkte dhe mbi çfarë baze garantohet servisimi dhe sigurimi i pjesëve origjinale gjatë periudhës garantuese**.

4. Autorizimet e lëshuara nga QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. për operatorë të ndryshëm ekonomikë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion përmes qasjes, kemi konstatuar se **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.** ka lëshuar autorizim për Operatorin Ekonomik **SHKELCEN SYLAJ B.I.**, me të cilin deklarohet se ky Operator Ekonomik është i autorizuar të ofertojë në procedurat e prokurimit në Republikën e Kosovës.

Mirëpo, nga dokumentacioni i njëjtë rezulton se **e njëjta kompani, QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.**, ka lëshuar autorizim edhe për një Operator tjetër Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, përkatësisht **AGRIBAU SH.P.K.**, duke e autorizuar edhe këtë Operator Ekonomik për të ofertuar në procedurat e prokurimit në Republikën e Kosovës.

Kjo rrethanë krijon një paqartësi të rëndësishme lidhur me natyrën, shtrirjen dhe vlefshmërinë e autorizimeve të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë, veçanërisht duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit është kërkuar **autorizim nga prodhuesi** për pajisjet e ofruara.

QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. nuk është prodhues, por furnizues/distributor, atëherë autorizimet e lëshuara nga kjo kompani nuk mund të konsiderohen automatikisht si përmbushje e kërkesës së Autoritetit Kontraktues për autorizim nga prodhuesi. Për më tepër, fakti që i njëjti subjekt ka autorizuar dy Operatorë Ekonomikë të ndryshëm pjesëmarrës në të njëjtën procedurë kërkon verifikim të veçantë nga Autoriteti Kontraktues.

Kjo çështje bëhet edhe më e rëndësishme nga përmbajtja e autorizimit të lëshuar për **AGRIBAU SH.P.K.**, ku QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. e përshkruan vetën me shprehjen **“who is established and reputable supplier”**, që në shqip nënkupton **“furnizues i konsoliduar dhe me reputacion”**.

Pra, nga vetë përmbajtja e autorizimit rezulton se subjekti që e ka lëshuar dokumentin e përshkruan vetën si **“supplier” (furnizues)**. Kjo është veçanërisht relevante për pretendimin tonë se QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. nuk është prodhues i pajisjeve, por subjekt që ushtron veprimtari të furnizimit dhe tregtimit.

PER AGRIBAU SHPK

1. Kundërthënia në autorizimet e lëshuara nga QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik **AGRIBAU SH.P.K.**, kemi konstatuar se ky Operator Ekonomik ka paraqitur një autorizim të lëshuar nga kompania **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.**, përmes të cilit deklarohet se **AGRIBAU SH.P.K.** është i autorizuar nga kjo kompani për të marrë pjesë dhe për të ofertuar në procedurat e tenderimit në Republikën e Kosovës në emër të saj.

Mirëpo, siç kemi theksuar edhe në pretendimet tona paraprake, e njëjta kompani, **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co.**, ka lëshuar një autorizim me përmbajtje të njëjtë ose shumë të ngjashme edhe për Operatorin Ekonomik **SHKELCEN SYLAJ B.I.**, duke e autorizuar edhe këtë Operator Ekonomik për të ofertuar në procedurat e prokurimit në Republikën e Kosovës.

Kështu, kemi të bëjmë me dy autorizime të lëshuara nga i njëjti subjekt për dy Operatorë Ekonomikë të ndryshëm, të cilët kanë qenë pjesëmarrës në të njëjtin aktivitet të prokurimit, me përmbajtje që në thelb deklaron të njëjtën marrëdhënie autorizimi.

Kjo rrethanë paraqet një **kundërthënie dhe paqartësi materiale** që kërkon verifikim nga Autoriteti Kontraktues, veçanërisht për faktin se autorizimet janë përdorur si dëshmi për përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në dosjen e tenderit.

Nëse QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. pretendon se është subjekt që ka të drejtë të autorizojë Operatorë Ekonomikë për të ofertuar në emër të saj në Republikën e Kosovës, atëherë duhet të sqarohet mbi çfarë baze dhe në çfarë cilësie janë lëshuar këto autorizime, si dhe nëse ky subjekt ka cilësinë e **prodhuesit**, të cilën e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues në FTD, apo është vetëm furnizues/distributor.

Për më tepër, duke pasur parasysh se nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. ka lëshuar autorizime për më shumë se një Operator Ekonomik pjesëmarrës në të njëjtën procedurë, konsiderojmë se Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve ka pasur detyrim që këtë rrethanë ta shqyrtojë dhe ta verifikojë në kuadër të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se deklaratat dhe dokumentet e lëshuara nga vetë QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT Co. duhet të jenë pjesë e vlerësimit të plotë dhe objektiv të ofertave, veçanërisht kur nga dokumentet e së njëjtës kompani mund të krijohen paqartësi apo kundërthënie lidhur me statusin e saj, natyrën e autorizimit dhe të drejtën për të lëshuar autorizime të tilla.

2. Paraqitja e vetëm një autorizimi nga prodhuesi për pajisjet e ofruara

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si kërkesë që Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin **autorizim nga prodhuesi për pajisjet të cilat i ofrojnë** në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë, kemi konstatuar se në dokumentacionin e ofertës është paraqitur **vetëm një autorizim**.

Megjithatë, nga përmbajtja e dokumentacionit të dorëzuar nuk është e qartë se ky autorizim mbulon të gjitha pajisjet e kërkuara dhe të ofruara në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, apo vetëm një pjesë të tyre.

Në rastin konkret, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për qasje, nuk mund të konstatohet qartë se për pajisjet e tjera të ofruara ekziston autorizimi përkatës nga prodhuesit. Paraqitja e vetëm një autorizimi, pa specifikuar qartë shtrirjen e tij dhe pa dëshmuar se cilat pajisje mbulohen me këtë autorizim, krijon paqartësi në lidhje me përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në FTD.

3. Autorizimi i prodhuesit

Në dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton se si dëshmi për përmbushjen e kërkesës së Autoritetit Kontraktues është dorëzuar një autorizim i lëshuar nga kompania **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT CO., LTD.**

Megjithatë, nga vetë përmbajtja e autorizimit të lëshuar nga kjo kompani, kemi evidentuar një element të rëndësishëm që është në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit.

Konkretisht, në përmbajtjen e autorizimit thuhet, citojmë:

“who is established and reputable supplier”

që në gjuhën shqipe nënkupton:

“furnizues i konsoliduar dhe me reputacion”.

Pra, nga vetë përmbajtja e dokumentit rezulton se subjekti në fjalë lidhet me veprimtarinë e **furnizimit**, dhe jo me cilësinë e **prodhuesit** të pajisjeve.

Kjo është në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), ku është kërkuar që Operatorët Ekonomikë të paraqesin **autorizim nga prodhuesi për pajisjet e ofruara**. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues nuk është formuluar si autorizim nga furnizuesi, distributori apo ndonjë subjekt tjetër tregtar, por specifikisht si **autorizim nga prodhuesi**.

Për më tepër, vetë emërtimi i kompanisë **QINGDAO RED LETTER IMPORT AND EXPORT CO., LTD.**, i cili përmban shprehimisht aktivitetet “IMPORT AND EXPORT”, së bashku me përshkrimin e saj në dokumentacion si “supplier”, krijon bazë të arsyeshme për të kërkuar verifikim të statusit real të kësaj kompanie dhe të kapacitetit të saj për të lëshuar autorizim në cilësinë e prodhuesit.

Në këto rrethana, konsiderojmë se Komisioni për Vlerësimin dhe Verifikimin e Tenderëve nuk është dashur të mjaftohet vetëm me ekzistencën formale të një dokumenti të titulluar “Authorization”, por është dashur të shqyrtojë përmbajtjen e tij dhe të verifikojë nëse subjekti që e ka lëshuar autorizimin e plotëson kriterin e përcaktuar në dosjen e tenderit, përkatësisht nëse është **prodhues** i pajisjeve për të cilat është dhënë autorizimi.

Veçanërisht, kur vetë dokumenti e cilëson subjektin si “supplier”, kjo rrethanë është dashur të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të ofertës dhe të sqarohet në mënyrë të

plotë përpara se autorizimi të pranohej si dëshmi për përmbushjen e kërkesës së FTD-së

KONKLUZION

Në bazë të fakteve, rrethanave dhe mospërputhjeve të evidentuara më lart, si dhe duke marrë parasysh dokumentacionin e shqyrtuar pas realizimit të së drejtës sonë për qasje në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, konsiderojmë se ekzistojnë arsye të bazuara për të kontestuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit nga Operatori Ekonomik i propozuar për dhënien e kontratës.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe fakteve të paraqitura në këtë parashtrësë:

1. **Të pezullojë procedurën e mëtejshme të këtij aktiviteti të prokurimit**, deri në shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me pretendimet tona;
2. **Të bëjë rishqyrtimin dhe rivlerësimin e ofertave**, duke marrë parasysh të gjitha faktet, dokumentet dhe mospërputhjet e evidentuara në pretendimet tona;
3. **Të verifikojë në mënyrë të plotë dokumentacionin e Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë**, në veçanti autorizimet e paraqitura dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara në Fletën e të Dhënave të Tenderit;
4. Pas verifikimit të plotë, nëse konstatohet se Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë nuk i përmbush kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, **ta shpallë ofertën e tij të papërgjegjshme**, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe kërkesat e dosjes së tenderit;
5. **Të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit**, pas përfundimit të procesit të rivlerësimit.

Konsiderojmë se shqyrtimi i këtyre çështjeve është i domosdoshëm për të siguruar që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë transparent, objektiv, i barabartë dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues në dokumentet e tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K. konsideron se kjo menyre vleresuese e demton kompanine tone e cila ka pervoje shum vjeqare ne furnizim e ne kete menyra pamundeson ushtrimin e aktivitetit ekonomike e ne te cilat eshte investuar ne staf te trajnuar. Demet tjeter material konsiston ne koston e pergaditjes se tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*